



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 12/2022 regjistër (JR)
Datë 17.02.2022

Nr. 45 i vendimit
Datë 02.06.2025

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 25.02.2025, ora 14:00, dhe më datë 02.06.2025, ora 10:10, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 12/2022 (JR), datë 17.02.2022, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Arqile Basho, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 486, datë 15.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 5, pika 2 dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 47 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes dhe vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Arqile Basho (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të kontrollit të figurës, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: *a) nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, në referim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose përdorim të tij, në referim të pikës 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës; b) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë¹ dhe ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te drejtësia.*
3. Mbështetur në sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenet A, Ç, D dhe DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 486, datë 15.12.2021, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arqile Basho, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.*

II. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimit nr. 486, datë 15.12.2021, të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, duke kërkuar:
 - i. *Prishjen e vendimit nr. 486, datë 15.12.2021, të Komisionit, të dhënë ndaj subjektit të rivlerësimit Arqile Basho.*
 - ii. *Riçeljen e hetimit administrativ, duke ripërsëritur tërësisht hetimin administrativ për kriterin e pasurisë, në mënyrë të posaçme:*
 - *Identifikimin e plotë të të ardhurave të subjektit dhe anëtarëve të familjes për të gjithë periudhën e rivlerësimit dhe përfshirjen e këtyre të ardhurave në analizën e treguesve financiarë;*
 - *Marrjen e provave shtesë të nevojshme për pasuritë në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe me qira në emër të tij dhe personave të lidhur, që kanë të bëjnë me identifikimin e plotë të tyre dhe të gjendjes së tyre;*
 - *Thirrjen në cilësinë e dëshmitarëve të personave të lidhur për të dhënë sqarimet dhe dokumentacionin e mundshëm mbi çdo pasuri në emër të tyre;*
 - *Thirrjen e personave qiradhënës B. P. dhe Q. P. ose personave që marrin drejtpërdrejt vlerat e qerasë përkatësisht A. P., Tiranë dhe K. L., Vlorë, për sqarimin e rrethanave dhe të vlerës së qirasë;*
 - *Këqyrjen e aktivitetit të një ha frutikulturë, gjendjes dhe marrjen e provave shtesë për mundësitë e prodhimit dhe vlerën e të ardhurave për çdo vit.*
 - iii. *Riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e kontrollit të figurës, duke kërkuar informacione shtesë nga organet publike apo institucione shtetërore, siç mund të jenë Dhoma*

¹ Shih konkluzionin përfundimtar në faqen 41 të vendimit të Komisionit.

e Avokatisë Vlorë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Gjykata, etj.

iv. Riçeljen e hetimit administrativ, duke plotësuar hetimin me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale.

v. Plotësimin e hetimit administrativ me tërësinë e elementëve dhe provave që KPA-ja do t'i vlerësojë të domosdoshme apo të nevojshëm për çdo kriter dhe për çdo aspekt të objektit të hetimit administrativ.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

a) Juridiksioni i Kolegjit

5. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”), si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, që ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arqile Basho, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

b) Legjitimitimi i ankuesit

6. Subjekti i rivlerësimit/ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma e shqyrtimit të ankimit

7. Trupi gjykues i Kolegjit shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen e juridiksionit të rivlerësimit, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Arqile Basho, ndaj vendimit nr. 486, datë 15.12.2021, të Komisionit, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”).
8. Gjatë shqyrtimit të çështjes, nga verifikimi i akteve të përcjella nga Komisioni në Kolegj, konkretisht në dosjen e krijuar nga hetimi i kryer nga ILDKPKI-ja, trupi gjykues konstatoi se referuar të dhënave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe certifikatës personale me nr. {***}, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, {***}, Bashkia Gjirokastër, datë 24.10.2016, subjekti i rivlerësimit Arqile Basho ka lindur më datë 18.01.1958, për rrjedhojë moshë e tij, në momentin e shqyrtimit të çështjes nr. 12/2022 (JR), është mbi 67 vjeç.
9. Në mbështetje të kësaj situatë faktike, si dhe bazuar në parashikimin e nenit 64 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

(në vijim “ligji nr. 96/2016”)², trupi gjykues çmoi se duhej vlerësuar paraprakisht plotësimi i kushteve ligjore për përfundimin e statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit, për shkak të mbushjes së moshës për daljen në pension pleqërie.

10. Për këtë qëllim, nga informacionet e përcjella në formë shkresore në Kolegj nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) dhe Gjykata Administrative e Apelit, në përgjigje të kërkesave të drejtuara nga relatorja e çështjes, në mbështetje të nenit 14, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016³, rezulton se:

10.1 KLGj-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 30.09.2024⁴, informoi fillimisht se nga verifikimet e kryera, deri në atë moment, pranë këtij institucioni nuk rezultonte të ishte paraqitur apo regjistruar kërkesë e subjektit të rivlerësimit Arqile Basho, për qëndrim në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Në vijim, KLGj-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 15.01.2025⁵, ka informuar se pas shqyrtimit të kërkesës për qëndrim në detyrë deri në moshën 70 vjeç, ka marrë vendimin nr. {***}, datë 15.01.2025, “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. Arqile Basho [...]”, përmes së cilit ka vendosur:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Arqile Basho, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë dhe refuzimin e kërkesës për qëndrimin në detyrë deri në moshën 70 vjeç.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 31.01.2025.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit Arqile Basho, sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

10.2 Gjykata Administrative e Apelit, me shkresën nr. {***} prot., datë 05.02.2025⁶, ka informuar se pranë kësaj gjykate është regjistruar ankimi i subjektit të rivlerësimit Arqile Basho kundër vendimit nr. {***}, datë 15.01.2025, të KLGj-së, me të dhënat si vijojnë: *Çështja me nr. {***} ({***}), datë 04.02.2025, që i përket palëve: kërkues Arqile Basho dhe palë e interesuar KLGj, me objekt: 1. Shfuqizimin e vendimit Nr.{***}, datë 15.01.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor Tiranë, për sa i përket disponimit “Refuzimin e kërkesës për qëndrimin në detyrë deri në moshën 70 vjeç” dhe ndryshimin e këtij disponimi duke vendosur: “Pranimin e kërkesës, zgjatjen e mandatit të magjistratit Arqile Basho, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së*

² Neni 64, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, përcakton se: “[...] Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension. Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaroi me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës [...]”.

³ Neni 14, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016, përcakton se: “5. Relatori i çështjes ka këto detyra: [...] ç) të kërkojë informacion shtesë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji; [...]”.

⁴ Regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 02.10.2024.

⁵ Regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 16.01.2025.

⁶ Regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 05.02.2025.

*Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, deri në mbushjen e moshës 70 vjeç, konkretisht datë 31.01.2028. 2. Shfuqizimin e vendimit Nr. {***}, datë 15.01.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor Tiranë, për sa i përket disponimit “Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Arqile Basho, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”.*

10.3 KLGj-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 11.02.2025⁷, ka informuar mbi ushtrimin e ankimit të z. Arqile Basho, pranë Gjykatës Administrative të Apelit, ndaj vendimit të shkurtuar nr. {***}, datë 15.01.2025, të KLGj-së, si dhe kërkesën për marrjen e masës për sigurimin e padisë “Pezullimin e efekteve të zbatimit të vendimit nr. {***}, datë 15.01.2025, të KLGj-së, deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes [...]”. KLGj-ja ka përcjellë në Kolegj kopjen e njoftimit nr. {***} akti, datë 07.02.2025, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe akteve shoqëruese, nga të cilat rezulton se kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë do të shqyrtohet në datën 10.02.2025.

10.4 Gjykata Administrative e Apelit, me shkresën nr. {***} prot., datë 24.02.2025⁸, ka informuar Kolegjin se kjo gjykatë, lidhur me çështjen që i përket kërkesit Arqile Basho, ka vendosur në dhomë këshillimi më datë 18.02.2025: “1. Refuzimin e kërkesës së kërkesit Arqile Basho për marrjen e masës së sigurimit të padisë. [...]”.

- 11.** Subjekti i rivlerësimit i kërkoj Kolegjit⁹ pezullimin e shqyrtimit të ankimit kundër vendimit nr. 486, datë 15.12.2021, të Komisionit, deri në shqyrtimin e ankimit të tij ndaj vendimit nr. {***}, datë 15.01.2025, të KLGj-së, nga Gjykata Administrative e Apelit.
- 12.** Në datën 20.02.2025, pas njoftimit të marrë për caktimin e datës së gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit depozitoi në Kolegj parashtrime mbi shkaqet e ankimit¹⁰, në të cilat shprehet se i qëndron pretendimeve të ngritura në ankim, duke kërkuar: “Prishjen e vendimit nr. 486, datë 15.01.2021, të Komisionit, të dhënë ndaj subjektit të rivlerësimit Arqile Basho”. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrime, ka sjellë sërish në vëmendje të trupit gjykues kërkesën për pezullimin e shqyrtimit të ankimit të tij ndaj vendimit të Komisionit.
- 13.** I mbledhur në dhomë këshillimi më datë 25.02.2025, për shqyrtimin e çështjes (JR) nr. 12/2022, datë 17.02.2022, pasi u njoh me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për pezullimin e shqyrtimit të ankimit, trupi gjykues i Kolegjit, me vendim të ndërmjetëm në datën 25.02.2025, vendosi rrëzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit Arqile Basho për pezullimin e gjykimit të çështjes dhe vijimin e gjykimit të saj në datën 02.06.2025, me arsyetimin se ai nuk gjendet në kushtet e pezullimit të gjykimit, sipas nenit 297 të Kodit të Procedurës Civile, pasi, në kuptim të kësaj dispozite ligjore, zgjidhja e çështjes objekt shqyrtimi në Kolegj mund të kryhet pavarësisht zgjidhjes së çështjes gjyqësore administrative, mbi ankimin e ushtruar prej tij në Gjykatën Administrative të Apelit, sa kohë që subjekti vijonte të kishte statusin e magjistratit, sipas nenit 64, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 100, pika 1, fjalja e parë e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Në këto kushte, duke mbajtur

⁷ Regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 11.02.2025.

⁸ Regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 24.02.2025.

⁹ Regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 06.02.2025.

¹⁰ Regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 20.02.2025.

në konsideratë natyrën *sui generis* të procesit të rivlerësimit dhe mandatin në kohë të kufizuar të Kolegjit, trupi gjykues e gjeti të pabazuar kërkesën për pezullim të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.

14. Nga informacionet e përcjella në vijim nga KLGj-ja dhe Gjykata Administrative e Apelit, rezulton sa vijon.

14.1 KLGj-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 11.03.2025¹¹, ka informuar Kolegjin se ky institucion i ka komunikuar z. Arqile Basho edhe vendimin e arsyetuar nr. {***}, datë 15.01.2025, për të cilin ai rezultoi të ketë marrë dijeni më datë 19.02.2025, duke përcjellë kopjen e vendimit të arsyetuar dhe lajmërimarrjen përkatëse.

14.2 Gjykata Administrative e Apelit, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.05.2025¹², përcolli shkurtimin e vendimit të çështjes me nr. {***} ({***}) Akti, nr. {***} ({***}) vendimi, datë 21.05.2025, që i përket palëve: paditës Arqile Basho dhe i paditur Këshilli i Lartë Gjyqësor, me të cilin ka vendosur: “1. Rrëzimin e kërkesëpadisë. 2. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse. 3. Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar. U shpall në Tiranë, sot, në datën 21.05.2025”.

15. Në analizë të fakteve të mësipërme, trupi gjykues konstatoi se si pasojë e vendimit të sipërcituar të Gjykatës Administrative të Apelit, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. {***}, datë 15.01.2025, të KLGj-së, z. Arqile Basho, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë dhe refuzimit të kërkesës së tij për qëndrimin në detyrë deri në moshën 70 vjeç, ka humbur statusin e magjistratit.
16. Rivlerësimi kalimtar i subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pika 3 e Kushtetutës kërkon si kusht logjik dhe juridik pasjen e statusit të magjistratit, për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*. Trupi gjykues konstatoi se në momentin e regjistrimit në Kolegji të çështjes nr. 12 (JR), datë 17.02.2022, për shqyrtimin e ankimit¹³ të subjektit të rivlerësimit Arqile Basho kundër vendimit nr. 486, datë 15.12.2021, të Komisionit, z. Arqile Basho gëzonte statusin e magjistratit, status të cilin e ka humbur me vendimin nr. {***}, datë 15.01.2025, të KLGj-së, për shkak të mbushjes së moshës për daljen në pension pleqërie, duke mosushtruar më detyrën e gjyqtarit dhe, për rrjedhojë, nuk bën më pjesë në rrethin e subjekteve që duhet t’i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016¹⁴.
17. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se objekti dhe qëllimi për të cilin kishte nisur procedura e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Arqile Basho është bërë i pamundur dhe nuk mund të vazhdojë në Kolegji.
18. Nisur nga fakti se subjektit të rivlerësimit i ka mbaruar statusi i magjistratit, për një nga rastet e parashikuara nga ligji, në kushtet kur Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016 nuk kanë parashikuar ndonjë rregullim të posaçëm për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar në

¹¹ Regjistruar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 11.03.2025.

¹² Regjistruar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 27.05.2025.

¹³ Ankim i depozituar nga subjekti i rivlerësimit, më datë 08.02.2022.

¹⁴ Neni 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “3. “Subjekt i rivlerësimit” janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës”.

rastin e daljes në pension të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, bazuar në pikën 6, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi se mund të zbatojë parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe konkretisht nenin 95 të tij, të titulluar “Pamundësia në objekt apo qëllim”, i cili parashikon se: “*Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur*”.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 64, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, me shumicë votash,

VENDOSI:

Përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Arqile Basho pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti dhe qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 02.06.2025.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi-kundër

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, për shqyrtimin e çështjes nr. 12/2022 (JR), jam kundër vendimit nr. 45, datë 02.06.2025, me të cilin shumica e trupit gjykues vendosi: *Përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Arqile Basho pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti dhe qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur.*
2. Ndaj qëndrim të kundërt me shumicën e trupit gjykues, për sa i përket mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të parashikimeve kushtetuese dhe legjisllacionit, që përbën paketën ligjore të reformës në drejtësi, në raport me situatën faktike e ligjore të konstatuara përgjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit të kësaj çështjeje.
 - 2.1. Komisioni, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 486, datë 15.12.2021, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arqile Basho, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.* Këtë masë disiplinore, Komisioni e ka dhënë pas përfundimeve se subjekti i rivlerësimit: -- nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij; -- ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose përdorim të tij, në referim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës; si dhe -- ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë dhe ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut të drejtësia.
 - 2.2. Ky vendim, nëpërmjet ankimit është kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili i ka kërkuar Kolegjit prishjen e vendimit të Komisionit, si dhe riçeljen dhe plotësimin e hetimit administrativ. Në parashtrimet mbi shkaqet e ankimit të depozituara në datën 20.02.2025, në Kolegj, subjekti i rivlerësimit i qëndron pretendimeve të ngritura në ankim, duke kërkuar: *Prishjen e vendimit nr. 486, datë 15.01.2021, të Komisionit, të dhënë ndaj subjektit të rivlerësimit Arqile Basho.*
3. Në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, pavarësisht se Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. {***}, datë 15.01.2025, kishte vendosur deklaramin e mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë dhe refuzimin e kërkesës për qëndrimin në detyrë deri në moshën 70 vjeç, procesi i rivlerësimit duhet të vijonte, duke qëndruar në rastin konkret i pakushtëzuar nga kjo vendimmarrje.
4. Këtë konkluzion e mbështes në argumentin se procesi i rivlerësimit për subjektin në fjalë kishte nisur e konkluduar nga Komisioni me një vendimmarrje për shkarkim nga detyra, vendimmarrje të cilën subjekti nëpërmjet mjetit procedural të ankimit e ka kundërshtuar, duke investuar në këtë mënyrë Kolegjin e Posaçëm të Apëlimit. Për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk është tërhequr nga pretendimet e tij të shprehura në ankim dhe në parashtrime, vullneti i subjektit në këtë rast për t'u rivlerësuar është i qartë, shumica e trupit gjykues, në funksion të juridiksionit të tij, duhet të kishte shqyrtuar vendimin e Komisionit dhe të dispononte në përputhje me parashikimet e nenit 66, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që përcakton se: *Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji i Apëlimit vendos: (a) lënie në fuqi të vendimit të Komisionit; (b) ndryshimin e vendimit të Komisionit; (c) prishjen e vendimit të Komisionit.* Vendimmarrja e shumicës, bazuar në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, në vlerësimin tim, nuk përfaqëson një zgjidhje të drejtë të çështjes dhe e konsideroj kapërcim të zbatimit të dispozitave që ligji parashikon për zgjidhje të rasteve të tilla.

5. Në vlerësimin tim, është detyrë e institucioneve të rivlerësimit dhe kryesisht Kolegjit, si e vetmja gjykatë e këtij procesi, që e udhëhequr nga parimi i procesit të rregullt ligjor, nëpërmjet mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të subjektit të rivlerësimit, të shqyrtonte vendimin e Komisionit nëpërmjet analizimit të shkaqeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe në parashtrime, në mënyrë që të finalizonte këtë proces për subjektin e rivlerësimit me një vendim përfundimtar, duke i dhënë përgjigje shkaqeve të ankimit të ushtruar prej tij, si dhe të vlerësonte bazueshmërinë nëse masa e shkarkimit të tij nga detyra e dhënë nga Komisioni ishte ose jo e drejtë e në përputhje me ligjin.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi